Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Komuna e Podujevës

Nr. 3

Podujevë, datë 24.08.2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi i tretë buxhetor për buxhetin e vitit 2027 të Komunës së Podujevës.

Mbajtur me datë 24 gusht 2026 nga ora 18:00.

Të dhënat e përgjithshme

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Podujevës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 15/09/2026 në emalin arbnore.uka@rks-gov.net ; liridona.rrahmani@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimit në Komunën e Podujevës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuara mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkëngjitura të cilat janë mbledhur gjatë takimit.

Veprimet para nisjes së takimit:

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve. Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre.

Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Të pranishmit janë pajisur me materialet ku përfshihej prezantimi i draft buxhetit i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpret për personat me aftësi të kufizuar.

Zhvillimet gjatë takimit:

Takimi ka nisur në ora 18:05 të pranishëm ishin nënkryetari i Komunës, Fahri Restelica, drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Arbnorë Uka-Osmani, drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Ahmet Ahmeti, drejtoresha e Kulturës, Rinisë dhe

Sportit, Valbona Ibshi- Azemi dhe anëtarja e grupit punues Liridona Rrahmani. Nga qytetarët morën pjesë 24 qytetarë prej të cilëve 21 burra dhe 3 gra.

(Shih aneks Fotografi nga takimi, shih në aneks listën e pjesëmarrësve)

Takimi u hap nga nënkryetari i Komunës, Fahri Restelica. "**Të nderuar banorë të fshatit Orllan dhe të fshatrave përreth,**

Ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë dëgjim publik, i cili po mbahet në kuadër të procesit të hartimit të Draft-Buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2027.

Këto dëgjime janë pjesë e procesit të konsultimit me qytetarët dhe kanë për qëllim që, para finalizimit të buxhetit, të dëgjojmë drejtpërdrejt nga ju se cilat janë nevojat dhe prioritetet e komunitetit tuaj.

Sot jemi këtu para së gjithash për t'ju dëgjuar juve. Prandaj, ndihuni të lirë t'i paraqisni kërkesat dhe propozimet tuaja, qoftë për rrugë, kanalizim, ujësjellës, ndriçim, arsim, shëndetësi apo çështje të tjera që i konsideroni të rëndësishme për vendbanimet tuaja.

Të gjitha kërkesat do të evidentohen në procesverbal dhe më pas do të shqyrtohen nga grupi punues. Në bazë të prioriteteve dhe mundësive buxhetore, do të synojmë që kërkesat e arsyeshme të qytetarëve t'i përfshijmë në Buxhetin e vitit 2027.

Pas përfundimit të ciklit të dëgjimeve do të hartohet dhe publikohet raporti përfundimtar, ku qytetarët do të mund të informohen për trajtimin e kërkesave të tyre.

Gjithashtu, kërkesat mund t'i paraqisni edhe në formë të shkruar përmes adresave elektronike të publikuara në njoftimet zyrtare të Komunës.

Edhe një herë, ju inkurajoj të flisni lirshëm dhe t'i paraqisni propozimet tuaja. Ne jemi sot këtu për t'ju dëgjuar dhe për t'i marrë kërkesat tuaja në shqyrtim gjatë hartimit të Buxhetit për vitin 2027" tha nënkryetari Restelica.

Të pranishmit u njoftuan nga zyrtarja për informim se për qëllime të dokumentimit të këtij takimi do hartohet procesverbali dhe komuna do publikoj video dhe fotografi nga ky takim.

Të gjithë të pranishmit dhanë pajtimin për regjistrimin e takimit dhe publikinin e imazheve nga ky takim.

Pas përfundimit të fjalës, mori fjalën drejtoresha për Buxhet dhe Financa

Pas përfundimit të fjalës së nënkryetarit, e mori fjalën drejtoresha për Buxhet dhe Financa, Arbnorë Uka-Osmani, e cila fillimisht falënderoi qytetarët për pjesëmarrje. “Të nderuar qytetarë, ju faleminderit për pjesëmarrjen në këtë dëgjim public, i cili po mbahet në kuadër të procesit të hartimit të Draft-Buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2027, si dhe planifikimeve buxhetore për vitet 2028–2029.

Qëllimi i këtyre dëgjimeve publike është që, para finalizimit të Draft-Buxhetit për vitin 2027, t'ju prezantojmë kornizën dhe mundësitë buxhetore të Komunës, linjat kryesore të shpenzimeve dhe investimeve, si dhe të dëgjojmë drejtpërdrejt nga ju kërkesat, propozimet dhe prioritetet që konsideroni se duhet të përfshihen në planifikimin buxhetor të vitit të ardhshëm.

Sipas kufijve të përcaktuar me Qarkoren e dytë buxhetore 2027/02 të Ministrisë së Financave, buxheti i përgjithshëm i planifikuar për Komunën e Podujevës për vitin 2027 është 35,849,049.00. Ky është kufiri buxhetor brenda të cilit Komuna duhet të planifikojë financimin e shërbimeve publike, funksionimin e administratës, arsimit dhe shëndetësisë, subvencionet, si dhe investimet kapitale për vitin 2027.

Sa i përket strukturës së shpenzimeve, pjesa më e madhe e buxhetit është e orientuar në paga dhe shtesa, për të cilat janë planifikuar rreth 20.9 milionë euro. Për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë paraparë rreth 3.77 milionë euro, ndërsa për shpenzimet komunale rreth 670 mijë euro.

Për subvencione dhe transfere janë planifikuar rreth 1.92 milionë euro, ndërsa një pjesë shumë e rëndësishme e buxhetit është e orientuar në investimet kapitale, për të cilat janë paraparë rreth 16.87 milionë euro. Përmes kësaj kategorie financohen projektet kapitale të Komunës, përfshirë projektet në vazhdim dhe projektet e reja që do të planifikohen në përputhje me prioritetet dhe mundësitë buxhetore.

Në kuadër të këtij buxheti financohen edhe dy prej sektorëve më të rëndësishëm për qytetarët, arsimi dhe shëndetësia. Në sektorin e arsimit buxheti mbulon funksionimin e institucioneve arsimore, pagat dhe shpenzimet e tjera të lidhura me ofrimin e shërbimeve arsimore, si dhe investimet e planifikuara në infrastrukturën shkollore. Në sektorin e shëndetësisë financohen shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor, personeli, funksionimi i institucioneve shëndetësore dhe investimet për përmirësimin e kushteve dhe cilësisë së shërbimeve. Qarkorja buxhetore gjithashtu parasheh harmonizimin dhe rritjen e stafit në arsim për hapjen e çerdheve të reja, si dhe në shëndetësi për hapjen e institucioneve të reja shëndetësore dhe zbatimin e politikave të reja.

Gjatë përgatitjes së buxhetit, Komuna duhet t'u japë përparësi projekteve që lidhen me realizimin e prioriteteve komunale, projekteve që janë në vazhdim nga vitet paraprake dhe për të cilat ekzistojnë obligime kontraktuale, si dhe projekteve të reja që konsiderohen prioritare dhe për të cilat ekzistojnë mundësi financiare.

Pikërisht këtu është edhe rëndësia e këtyre dëgjimeve publike. Ne dëshirojmë që planifikimi i buxhetit të mos bëhet vetëm nga institucionet komunale, por që në këtë proces të përfshihen edhe qytetarët. Ju i njihni më së miri nevojat e lagjeve dhe fshatrave ku jetoni dhe për këtë arsye propozimet tuaja janë të rëndësishme për përcaktimin e prioriteteve për vitin e ardhshëm.

Prandaj, gjatë këtij dëgjimi ju ftojmë që t'i paraqisni kërkesat dhe propozimet tuaja, qoftë për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve, ujësjellës dhe kanalizim, trotuare, ndriçim publik, infrastrukturë shkollore dhe shëndetësore, sport, kulturë, mjedis, hapësira publike, apo për çështje dhe projekte të tjera që i konsideroni të nevojshme për komunitetin tuaj.

Të gjitha kërkesat dhe propozimet që do të paraqiten gjatë këtyre dëgjimeve do të evidentohen dhe do të merren në shqyrtim gjatë procesit të mëtejshëm të hartimit të Draft-Buxhetit. Natyrisht,

mundësia e përfshirjes së tyre do të varet nga kufijtë buxhetorë, prioritetet e Komunës, projektet që tashmë janë në realizim dhe kriteret që duhet të respektohen gjatë planifikimit buxhetor.

Buxheti i Komunës për vitin 2027 është buxhet që duhet t'u përgjigjet sa më mirë nevojave të qytetarëve dhe zhvillimit të Komunës së Podujevës. Për këtë arsye, pjesëmarrja juaj sot dhe propozimet që do të paraqisni janë pjesë e rëndësishme e këtij procesi.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj.

Në vazhdim do ta hapim diskutimin për kërkesat, propozimet dhe prioritetet tuaja për Draft-Buxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2027.

Kërkesat e qytetarëve në dëgjim:

Durime Bajrami:

1. Kërkesa jonë është të na mundësohet çasja në rrugën tonë, ne nuk kemi çasje qe sa kohë, nga viti 2019, ju kemi drejtuar shumë herë komunës, mirëpo ende nuk na keni ofruar zgjidhje, a ka mundësi me shtru me zhavorr këtë pjesën tonë për casje në rrugë

Memo Arifi

1. Kërkesë për trajtimin e ujit, liqeni i Batllavës përmban mirkroplastik, është shumë i dëmshëm, prandaj keni kaq shumë njerëz të sëmur, ju lutem ndërmerrni diçka për hir të shëndetit, pastrojeni liqenin urgjentisht

Naim Bajrami

1. Kërkesë për ndërtimin e sallës së Edukatës Fizike
2. Kërkesë për ndërtimin e fushave të hapura të sportit, në cilën fazë jemi ?
3. Kërkesë për mbulimin e gropave skeptike
4. Kërkesë për ndërtimin e këndit të lojrave
5. Kërkesë për rrethoja në shkollën e Brainës
6. Kërkesë për me i vendos pengesat në rrugë, sepse po lëvizin veturat me shpejtësi të lartë
7. Kërkesë për vendosjen e kamerave nga penda e liqenit e deri ne Orllan
8. Kërkesë për furnizim të nje makine fshirse për klasa
9. Kërkesë për ndërrimin e dyerve dhe dritareve nëpër klasa në shkollë
10. Probleme me furgonin për bartjen e nxënësve, deri me 16 tetor është afati i fundit, ku jemi me procedura të prokurimit?
11. Kërkesë për shtim të titujve të rinj në bibliotek të shkollës
12. Vendimi i vitit 2013 që ka qenë për rrënime a mundet me u ndërruar, si mundet minsitria pa diskutim publik me na sjell vendime për rrënim ne fshatin Orllan
13. Kërkesë për rregullim të rrugës me 2-3 kamionë zhavor, në hymje të shkollës, rrugë rreth 200 metra
14. Kërkesë për rregullimin e parkingut të shkollës

Muharrem Hoxha

1. Kërkesë për legalizim të shtëpive
2. Shkolla e vjetër edhe 2 vjet i bën 100 vjeter, a mundeni me vendos në projekt me bë diçka?
3. Kërkesë për të ndarë parcela për varreza
4. Kërkesë për rregullimin e një rrugë te lagjia “Osaj” ne gjatësi rreth 2 km

Vehbi Abdullahu – Brainë

1. Kërkesë për rregullim e rrugës "Shaban Zeqiri"
2. Kërkesë që nxënësit e shkollës në Brainë, me qenë vetëm në një ndërrim
3. Kërkesë për rregullimin e rrugës që lidh Brainen me fshatin Nishec, është rreth 1 km

Bahri Retkoceri – Bllatë

1. Ne e kemi rrugën e mbullur tash e sa kohë, rastin e dinë të gjithë, kërkësa ime është me pas çasje në rrugë, jemi 4 fshatra që na u është blloku çasja tash e sa vite, ju lutem bëni një zgjidhje për neve

Isak Shabani

1. Kërkesë gjithashtu për rrugën e quajtur "Kodra" kur kemi raste me njerëz të sëmur nuk mundemi me kalu andej, është e pa kalushme, gjatësia është 4 km
2. Këkesë për investime më të mëdha, sepse sipas PZHK, kësaj pjese i është dhënë rëndësi e veçantë zonës së Orllanit.
3. Kërkesë për rregullim të kanalizimit në Orllan
4. Kërkesë për ndërtimin e një parku afër Mileniumit, mendoj park me pisha, me ulëse, me trotuar, me kënd të lojrave

Rexhep Avdiu

1. Kërkesë për pajisje me leje për investime, sepse kam tokë dhe dëshiroj të investoj, toka ngjitur nga xhamia e deri atje lartë, dëshirojmë që të na lejohet ndërtimi, sepse kudo që kam shëtitur në cdo vend në Evropë, investimet më të mira janë përreth liqeneve

Sylejman Rrahmani -Turuçicë

1. Kërkesë për rregullimin e rrymës, pse pjesa dërmuese e fshati Turuçicë nuk ka rrymë?
2. Kërkesë që të bashkohet rruga e Herticës me fshatin Turuçicë
3. Në fshatin Turuçicë ka borë shumë vazhdimisht, jemi jasht kycjes së kanalizimit për rreth 250 metra, kërkesë për kanalizim
4. Kërkesë për regjistrim të gjitha ekonomive familjare në sistemin e pagesave për mbeturina

Kastriot Halimi

1. Kërkesë për ndriçim, rreth 250 metra lagjia jonë nuk ka ndriçim publik

Avdullah Shabani

1. Kërkesë për kanalizim, me qenë në projekt numër 1, po na shkakton shumë problem kjo çështje
2. Kërkesë që QMF të punojë me dy ndërrime
3. Kërkesë për rregullim të një vije natyrore të ujit, sepse kur po bjen shi po na vërshon si përrua, gjatësia e vijës mund të jetë rreth 150 metra

Halil Munishi

1. Kërkesë për rrymë, kemi probleme vazhdimisht në fshatin Turuçicë, a mundeni te na ndihmoni sidomos pjesën qe jemi mbi shkollë

Përfundimi

Në fund të takimit palët janë njoftuar se dëgjimet buxhetore do vazhdojnë sipas kalendarit të paraparë dhe poashtu janë njoftuar se komnetet mund ti dërgojnë të shkruara në emaillat e komunës liridona.rrahmani@rks-gov.net dhe arbnore.uka@rks-gov.net.

Takimi u mbyll në ora 19:55.

Në këtë takim kontribuan me pjesëmarrje 24 persona, më gjithësej 38 kërkesa të regjistruara.

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësev të ndarë sipas gjinisë.

Gra	3
Burra	21
Totali	24

Procesmbajtësja,

Liridona Rrahmani

Foto 1. Fotografi gjatë mbajtjes së takim








DERI NË 100
1 2 3 4 5 6 7 8 9 10



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik për Projekt-Buxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2027 – Orllan me rrethinë

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1.	Rexhep Zeka	ORLLAN	
2.	Sylejman Rrahmani	TURUSICË	
3.	Fejzi Zeqiri	KALDIC	
4.	Durim Bajrami	Orllan	
5.	Imer Bajrami	Orllan	
6.	Sahit Zuka	Orllan	
7.	Bejta "	"	
8.	KASTRIOT HALIMI	ORLLAN	
9.	Antigone Syla	Orllan	
10.	REXHEP AVDIU	ORLLAN	
11.	Vullnet Hoxha	ORLLAN	
12.	SHPETIM HOXHA	ORLLAN	
13.	Mehmeti Arif	Boraniq	
14.	EMRI ABDULLAHU	BRAINË	
15.	Abdullah Shabani	Orllan	
16.	HILMIM HAJITI	ORLLAN	
17.	HALIL MUNISHI	TURUCIC	
18.	Ahmet Hoxha	Orllan	
19.	ISAK SHABANI	ORLLAN	
20.	LIRIDONA RRAHMANI		

Me nënshkrimin tim në listën e Komunës, konfirmoj se Komuna mund t'i përdorë kontaktet e ofruara nga ana ime për të më dërguar njoftime periodike lidhur me ngjarje që janë në interes publik.

Po ashtu, me nënshkrimin tim konfirmoj se autoritetet komunale kanë të drejtë të regjistrojnë takimin për qëllime të hartimit të procesverbalit, si dhe të publikojnë fotografi dhe materiale video nga këto takime, në funksion të transparencës.

Podujevë 24.08.2026

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik për Projekt-Buxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2027 – Orllan me rrethinë

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			
6.			
7.			
8.			
9.			
10.			
11.			
12.			
13.			
14.			
15.			
16.			
17.			
18.			
19.			
20.			

Me nënshkrimin tim në listën e Komunës, konfirmoj se Komuna mund t'i përdorë kontaktet e ofruara nga ana ime për të më dërguar njoftime periodike lidhur me ngjarje që janë në interes publik.

Po ashtu, me nënshkrimin tim konfirmoj se autoritetet komunale kanë të drejtë të regjistrojnë takimin për qëllime të hartimit të procesverbalit, si dhe të publikojnë fotografi dhe materiale video nga këto takime, në funksion të transparencës.

Podujevë 24.08.2026